



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 35 datë 26.10.2023**

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË  
NGURTA URBANE (MNU) BASHKIA SHKODËR ”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 36.10.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr.8419, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Nenin 54, shkronja “k” të ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin Nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”; Ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, të ndryshuar ; Ligjin Nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar; Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar; Ligjin nr. 9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”; Ligjin Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”; Ligjin Nr.89/2022 “Për policinë Bashkiake”; VKM Nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake”; VKM Nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”;VKM Nr.660, datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”;VKM Nr.608, datë 17.9.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”; VKM nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", të ndryshuar; VKM nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura; VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"; VKM nr.117, datë 13/02/2013 "Për kriteret në bazë të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje", të ndryshuar VKM nr.957, datë 19/12/2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";VKM nr.866, datë 04/12/2012 "Për

bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre";VKM nr.765, datë 07/11/2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura";VKM nr.705, datë 10/10/2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës"; VKM nr.452, datë 11/07/2012 "Për lëndfill-et e mbetjeve", të ndryshuar ;VKM nr.177, datë 06/03/2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", të ndryshuar ;VKM nr.178, datë 06/03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve"; VKM Nr.319, datë 31.05.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"; VKM nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035", VKM Nr.447, datë 16.06.2010 "Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit"; VKM Nr.652 datë 14.09.2016 "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura;Urdher nr.994 datë 30.08.2023 "Mbi miratimin dhe zbatimin e PSV për administrimin e Ofrimit të Shërbimit të Pastrimit për Bashkinë Shkodër" si dhe relacionit të përgatitur nga administrata e bashkisë Shkodër;

### VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për Miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta Urbane (Mnu) Bashkia Shkodër" sipas materialit bashkëngjitur, pjesë integrale e këtij vendimi.
2. Kjo rregullore zbatohet me ndryshimin e paketës fiskale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

**KRYETAR**

**Oltion LULLI**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

**Denis Lesha**

Miratuar me 45 vota

Vota Pro 45

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 31.10.2023



---

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
BASHKIA SHKODËR

---

---

**RREGULLORE**  
**“PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË NGURTA URBANE (MNU)”**  
**BASHKIA SHKODËR**

## PËRMBAJTJA

<b>KREU I.....</b>	<b>6</b>
<b>DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI MENAXHIMIN E MNU.....</b>	<b>6</b>
Neni 1 .....	6
<b>QËLLIMI .....</b>	<b>6</b>
Neni 2 .....	6
<b>OBJEKTIVAT E RREGULLORES .....</b>	<b>6</b>
Neni 3 .....	7
<hr/>	
<b>BAZA LIGJORE.....</b>	<b>7</b>
Neni 4 .....	8
<b>AKTORET.....</b>	<b>8</b>
Neni 5 .....	8
<b>PERCAKTIMI I TERMAVE.....</b>	<b>8</b>
Neni 6 .....	11
<b>PROCESI I MENAXHIMIT TË MNU.....</b>	<b>11</b>
Neni 7 .....	11
<b>FAZAT E MENAXHIMIT TE MNU .....</b>	<b>11</b>
Neni 8 .....	12
<b>MBETJET OBJEKT I RREGULLORES.....</b>	<b>12</b>
Neni 9 .....	12
<b>MBETJE TË TJERA JO OBJEKT I RREGULLORES.....</b>	<b>12</b>
<b>KREU II.....</b>	<b>12</b>
<b>VEÇIMI, SISTEMIMI DHE DORËZIMI I MBETURINAVE .....</b>	<b>12</b>
Neni 10 .....	12
<b>VEÇIMI DHE SISTEMIMI I MNU .....</b>	<b>12</b>
Neni 11 .....	13
<b>MËNYRA E VENDOSJES TË KONTENIERËVE .....</b>	<b>13</b>
Neni 12 .....	13
<b>DORËZIMI I MNU.....</b>	<b>13</b>
Neni 13 .....	13
<b>MJEDISËT PUBLIKE .....</b>	<b>13</b>
Neni 14 .....	13
<b>KUFIZIMET PËR DORËZIMIN E MBETURINAVE URBANE .....</b>	<b>13</b>

Neni 15 .....	14
PERDORIMI I KONTENIEREVE PUBLIKE .....	14
<b>KREU III.....</b>	<b>14</b>
<b>GRUMBULLIMI, LARGIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE.....</b>	<b>14</b>
Neni 16 .....	15
GRUMBULLIMI I MBETURINAVE .....	15
Neni 17 .....	15
GRUMBULLIMI I MBETJEVE JO TË DIFERENCUARA.....	15
<hr/> <b>Neni 18.....</b>	<b>15</b>
GRUMBULLIMI ME KONTENIERE.....	15
Neni 19 .....	16
GRUMBULLIMI DERË MË DERË .....	16
Neni 20 .....	16
Vendosja dhe karakteristikat e konteniereve .....	16
Neni 21 .....	17
RUAJTJA HIGJENO - SANITARE PER PUNONJESIT E SHERBIMIT .....	17
Neni 22 .....	17
TRANSPORTI I MBETJEVE URBANE.....	17
Neni 23 .....	17
PESHIMI I MBETJEVE URBANE .....	17
<b>KREU IV .....</b>	<b>18</b>
<b>ROLI I BASHKISË NË MENAXHIMIN E MNU .....</b>	<b>18</b>
Neni 24 .....	18
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I SHËRBIMIT NË BASHKI .....	18
<b>KREU V .....</b>	<b>19</b>
<b>PASTRIMI DHE MIREMBAJTJA E RRUGËVE.....</b>	<b>19</b>
Neni 25 .....	19
SHËRBIMI I PASTRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE.....	19
Neni 26 .....	19
FSHIRJA DHE LARJA MEKANIKE E RRUGËVE.....	19
Neni 27 .....	20
FSHIRJA MANUALE E RRUGËVE.....	20
<b>KREU VI .....</b>	<b>20</b>

<b>DIFERENCIMI I MBETJEVE DHE QENDRA E MULTIGRUMBULLIMIT .....</b>	<b>20</b>
Neni 28 .....	20
<b>DORËZIMI DHE GRUMBULLIMI I MBETJEVE URBANE NË MËNYRË TË DIFERENCUAR .....</b>	<b>20</b>
Neni 29 .....	21
GRUMBULLIMI I DIFERENCUAR .....	21
<b>KREU VII .....</b>	<b>21</b>
<b>ROLI I BIZNESEVE DHE KOMUNITETIT NË MENAXHIMIN E MNU .....</b>	<b>21</b>
Neni 30 .....	21
<hr/> <b>PASTRIMI I TERRITOREVE .....</b>	<b>21</b>
Neni 31 .....	21
SHERBIMI I PASTRIMIT NE TREGJE .....	21
Neni 32 .....	22
MANIFESTIMET PUBLIKE, PANAIRET, SPEKTAKLET LËVIZËSE DHE VEPRIMTARI TË STINËS .....	22
<b>KREU VIII .....</b>	<b>22</b>
<b>INFORMIMI I PUBLIKUT PER MENAXHIMIN E MNU .....</b>	<b>22</b>
Neni 33 .....	22
DETYRIMI PER INFORMIM .....	22
Neni 34 .....	23
FUSHATAT E INFORMIMIT DHE TE SENSIBILIZIMIT .....	23
Neni 35 .....	23
OPINIONI I QYTETAREVE .....	23
Neni 36 .....	24
BASHKEPUNIMI ME ORGANIZATA JO FITIMPRURESE .....	24
<b>KREU IX .....</b>	<b>24</b>
<b>ORARET E HEDHJES SE MBETJEVE PER FAMILJARET, ENTET PUBLIKE DHE BIZNESET .....</b>	<b>24</b>
Neni 37 .....	24
ORARET E HEDHJES SE MBETJEVE URBANE .....	24
<b>KREU X .....</b>	<b>25</b>
<b>KONTROLLI DHE SANKSIONET .....</b>	<b>25</b>
Neni 38 .....	25
NDALIME DHE DETYRIME .....	25
Neni 39 .....	26
KONTROLLI .....	26

Neni 40.....	26
SANKSIONET PËR SHKELJEN E RREGULLORES.....	26
<b>Aneksi "A".....</b>	<b><u>27+28</u></b>

---

---

## KREU I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI MENAXHIMIN E MNU

#### NENI 1

##### QËLLIMI

Kjo rregullore synon të krijojë një mjedis të favorshëm për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane duke:

- përcaktuar detyrimet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve që janë të përfshirë në procesin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- analizuar të gjithë elementet teknik të sistemit (grumbullimi, fshirja, larja, transporti, reduktimi, riciklimi, kompostimi dhe trajtimi);
- siguruar një monitorim periodik në procesin e zbatimit të tyre;
- siguruar një menaxhim sa më eficient të mbetjeve urbane dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimit të pastrimit në Bashkinë Shkodër.

#### NENI 2

##### OBJEKTIVAT E RREGULLORES

Fokusi i kësaj rregullore është krijimi i një mjedisi të shëndetshëm për banorët e qytetit të Shkodrës duke përcaktuar rregullat specifike, teknikat më të mira të vlefshme dhe mënyrat e menaxhimit mjedisor të qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta urbane në çdo fazë të menaxhimit të tyre, që nga prodhimi deri në fazën finale të trajtimit të mbetjeve.

Më konkretisht kjo rregullore përfshin:

- Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbetjeve;
- Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve;
- Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;
- Marrjen e masave parandaluese për mosdjegien e mbetjeve në kazanë, për mos'hedhjen e mbetjeve në rrymat ujore dhe kanalizimet, apo në vende të tjera nga ato të miratuara nga bashkia;
- Marrjen e masave për sigurimin e një pastërtie të pranueshme duke dezinfektuar kontenierët dhe koshat rrugorë të depozitimit të mbetjeve;

Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbetjeve (operatorët e mbetjeve, industria e mbetjeve) në zbatim të legjislacionit në fuqi, ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar dhe ligjit Nr.10448 datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar.



NENI 3  
BAZA LIGJORE

Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;  
Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;  
Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”  
Ligji Nr. 8094, datë 21.03.1996 “ Për largimin publik të mbeturinave”;  
Ligji Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar ;  
Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar ;  
Ligji Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;  
Ligji Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”;  
Ligji Nr.89/2022 “Për policinë Bashkiake”  
VKM Nr.452, datë 26.07.2023“Për miratimin e rregullores kuadër të policisë Bashkiake”;  
VKM Nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave menaxhimin e mbetjeve inerte”;  
VKM Nr.660, datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”;  
VKM Nr.608, datë 17.9.2014 “Për Përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”;  
VKM Nr.687 datë 29.07.2015 "Për miratimin për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve", i ndryshuar ;  
VKM Nr.127 datë 11.02.2015 "Për kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujrave të ndotura”;  
VKM Nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim";  
VKM Nr.117, datë 13.02.2013 "Për kriteret në bazë të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qëni mbetje", i ndryshuar ;  
VKM Nr.957, datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike";  
VKM Nr.866, datë 04.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre";  
VKM Nr.765, datë 07.11.2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura";  
VKM Nr.705, datë 10.10.2012 "Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës";  
VKM Nr.452, datë 11.07.2012 "Për lëndfill-et e mbetjeve", të ndryshuar ;  
VKM Nr.177, datë 06.03.2012 "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre", të ndryshuar ;  
VKM Nr.178, datë 06.03/2012 "Për incinerimin e mbetjeve";  
VKM Nr.319, datë 31.05.2018 “Per miratimin e masave per kostot e manaxhimit te integruar te mbetjeve”;  
VKM Nr.418, datë 27.05.2020 "Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020-2035";  
VKM Nr.447, datë 16.06.2010 “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”;  
VKB Nr. 1, datë 22.01.2016 “ Për taksat dhe tarifat vendore në bashkinë Shkodër”, i ndryshuar;  
VKM Nr.652 datë 14.09.2016 “ Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve për gomat e përdorura.  
Ligjit nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta”  
Urdhëri Nr994, datë 30.08.2023 “ Mbi miratimin dhe zbatimin e PSV për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për Bashkinë Shkodër”.

NENI 4  
AKTORET

Zbatimit të kësaj rregulloreje i nënshtrohen:

- Bashkia Shkodër me departamentet përkatëse të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, Drejtoria e Mjedisit, Policia Bashkiake, Administratat e lagjeve njësia administrative Shkodër, dhe të gjitha njësitë e tjera administrative të Bashkisë Shkodër etj;
- Të gjitha institucionet shtetërore dhe organizmat vendorë;
- Të gjithë banorët e qytetit dhe njësite administrative të Bashkisë Shkodër, kalimtarë të rastësishëm, turistë dhe pushues, shtetas të huaj resident në qytet, punonjës në organe e organizma publike e private;
- Gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregtare, shoqërore, arsimore, kulturore, artistike, shëndetsore, turistike;
- Personat juridike e fizike, publike dhe private, vendas apo të huaj, të angazhuar me kontratë dhe të liçensuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave.

NENI 5  
PERCAKTIMI I TERMAVE

Në kuptimin e kësaj rregulloreje:

- a. **“Mbeturina”** janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaria njerëzore ose ciklet natyrore të destinuara për braktisje;
- b. **“Menaxhim i integruar i mbetjeve”** është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëteper edhe kontrollin e fushave të shkarkimit dhe impianteve të trajtimit mbas mbylljes së aktivitetit;
- c. **“Mbetje e ngurtë”**<sup>1</sup> është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t'i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit
- d. **“Mbetje bio”** janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, kateringut dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.
- e. **“Mbetje shtëpiake”**<sup>2</sup> janë mbetjet e sektorit familjar nga komunat, bashkitë dhe qarqet apo nga nënndarjet e tyre, si dhe mbetjet e tjera që, për shkak të natyrës ose përbërjes së tyre, janë të njëjta me mbetjet shtëpiake nga komunat, bashkitë dhe qarqet ose nënndarjet e tyre.
- f. **“Mbetjet bashkiake”** quhen mbetjet e ngurta dhe shtëpiake, në zbatim të ligjit të mbetjeve; MNU – shkurtim i **“Mbetje e Ngurtë Urbane”** ;

<sup>1</sup> Ligji nr 10463/2011 I ndryshuar “ Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” neni 3 pika 20

<sup>2</sup> Ligji nr 10463/2011 I ndryshuar “ Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” neni 3 pika 23

<sup>3</sup> VKM nr 575/2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”, pika 4

- g. **“Mbetje inerte”**<sup>3</sup> janë ato mbetje që nuk i nënshtrohen ndonjë transformimi të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik. Mbetjet inerte nuk treten, nuk digjen, nuk ndërveprojnë fizikisht dhe as nuk hyjnë në reaksione kimike, nuk biodegradojnë e nuk ndikojnë negativisht në lëndë të tjera, me të cilat bien në kontakt, në mënyrë të tillë që mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit ose të dëmtojnë shëndetin e njeriut. Aftësia totale për të lëngëzuar, përmbajtja e ndotësve dhe ekotoksiciteti i lëngjeve kulluese të mbetjeve inerte duhet të jenë të pakonsiderueshme dhe në mënyrë të veçantë nuk duhet të vënë në rrezik cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose të ujërave nëntokësore.
- h. **“Mbetje e lëngshme”** është çdo mbetje në trajtë të lëngshme, përfshirë ujërat e përdorura, por përjashtuar llumrat.
- ~~i. **“Mbetje të rrezikshme”**<sup>4</sup> janë ato mbetje që shfaqin një ose më shumë nga vetitë e rrezikshme, të listuara në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve.~~
- j. **“Vajra të përdorura”** janë të gjitha vajrat minerale, lubrifikantë sintetikë apo industriale që janë bërë të papërshtatshëm për përdorimin, për të cilin ishin prodhuar fillimisht. Vajrat e përdorura përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në vajrat e përdorura të motorëve me djegie të brendshme dhe vajrat e kutisë së ndërrimit të marsheve, vajrat lubrifikuese, vajrat për turbinat, vajrat për transformatorë dhe vajrat hidraulike.
- k. **“Mbetje të vëllimshme”** janë mbetje me përmasa të mëdha pajisjesh e makinerish, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave kryhet me metoda e teknika të veçanta; përfshihen objektet e mëdha, të mirat me konsumim të qëndrueshëm si: elektroshtëpiake, pajisjet informatike, mobilje, pjesë autoveturash, metale dhe mbeturina të tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave pengojnë përdorimin e metodave të zakonshme të mbledhjes, transferimit ose hedhjes së tyre;
- l. **“Mbetje të ambalazheve”** janë të gjitha ambalazhet ose materialet e tyre që mbulohen nga përkufizimi i mbetjes në ligj, me përjashtim të tepricave që mbesin nga prodhimi i tyre;
- m. **“Mbetje nga gomat e përdorura”** janë mbetjet që krijohen nga gomat e vjetëruara , të dëmtuara, që janë zëvendësuar dhe kur automjetet arrijnë në fundin e jetës të tyre;
- n. **“Dorëzimi”** quhet nxerrja dhe hedhja e mbeturinave urbane nga prodhuesit e tyre në pikat e grumbullimit të mbetjeve;
- o. **“Grumbullim”** është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.
- p. **“Grumbullim me kontenerë”** është operacioni i largimit të mbetjeve në pika grumbullimi fikse, paraprakisht të përcaktuara nga Bashkia, jashtë vendeve të prodhimit të mbetjeve, ku prodhuesi dorëzon direkt mbetjet;
- q. **“Grumbullim i diferencuar”** është grumbullimi, sipas të cilit një rrymë mbetjesh ndahet, në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik.
- r. **“Ndarje e mbetjeve në burim”** është ndarja e mbetjeve urbane në fraksione të ndryshme sipas përbërjes merceologjike të tyre për të lejuar rikuperimin dhe/ose ripërdorimin;
- s. **“Grumbullim me kontenerë publik”** quhet operacioni i largimit të mbetjeve në pika grumbullimi fikse, paraprakisht të përcaktuara nga bashkia, jashtë vendeve të prodhimit të mbetjes, ku prodhuesi dorëzon direkt mbetjet;

<sup>4</sup> Ligji nr 10463/2011 I ndryshuar “ Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” neni 3 pika 22

- t. **"Transportim"** është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.
- u. **"Trajtim"** janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.
- v. **"Lendfill"** është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë:
- (a) një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i lendfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit;
- (b) një vend të përhershëm që përdoret për ruajtjen e përkohshme, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të:
- impianteve ku mbetjet shkarkohen për t'u përgatitur për t'u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër;
  - vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se tre vjet përpara se të rikuperohen ose të trajtohen;
  - vendet ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre.
- w. **"Parandalim"** janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet: a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre; b) ndikimi i padëshirueshëm i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut; c) përmbajtja e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.
- x. **"Rikuperim"** është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që: a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdreshin në rast të kundërt për të përmbushur një funksion të caktuar; b) mbetjet të përgatiten për të përmbushur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë.
- y. **"Ripërdorim"** është çdo operacion, me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar
- z. **"Riciklim"** është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t'u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t'u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t'i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse.
- aa. **"Stokim i mbeturinave"** quhet procesi i ruajtjes(depozitimit) te produktit pas perpunimit te mbeturines derine destinacionin perfundimtar.
- bb. **"Qender multigrumbullimi"** jane pika grumbullimi te ruajtura, te destinuara per dorezimine materialeve te rikuperueshme, te rrezikshme ose voluminoze te mbetjeve urbane.Këto qendra përcaktohen, ndërtohen dhe menaxhohen në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mjedisit.
- cc. **"Shesh ekologjik"** eshte siperfaqe e betonuar, me strukturë te pershtatshme, per dorezirnin e mbetjeve te vellimshme. Këto sheshe ndërtohen në zbatim të Kuadrit ligjor në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse.
- dd. **"Person"** është cdo person fizik ose juridik;
- ee. **"Prodhues i mbetjeve"** është çdo person, veprimtaritë e të cilit krijojnë mbetje, (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.

- ff. “Vendndodhja e mbetjeve” është vendi ku ndodhet lëndëfilli apo incineratori apo çdo vend tjetër ku, sipas këtij ligji, lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve.
- gg. “Operator i shërbimit” është shoqëria/ndërmarrja, të cilës nëpërmjet kontratave të shërbimit, bashkia i beson dhe/ose lejon administrimin e mbetjeve të ngurta;
- hh. “Pastrimi i rrugëve” është shërbimi publik manual ose i mekanizuar i heqjes së mbetjeve të rena në rrugë apo hapësira publike, duke përfshirë këtu parqe dhe hapësira të gjelbërta, ose rrugë dhe hapësira private objekt i përdorimit publik;
- ii. “Zonë e kontratës” quhet zona brenda kufijve të vijës së verdhë, ku kontraktuesi do të sigurojë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve ndaj konsumatorëve ekzitues, si dhe atyre që mund të shtohen gjatë kohështrirjes së kontratës brenda të njëjtës zonë. Kufijtë e zonës së kontratës përcaktohen nga bashkia.
- jj. “Zonë e larjes” quhet shërbimi i lagjes së rrugëve, pa trotualet e rrugëve.

## NENI 6

### PROCESI I MENAXHIMIT TË MNU

Procesi i menaxhimit të MNU synon:

- Të parandalohet çdo dëm ose rrezik për shëndetin dhe ndotja e mjedisit nga mbetjet e ngurta urbane dhe të reduktohet ndikimi kur ai ndodh;
- Të përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve;
- Në të gjitha fazat e menaxhimit prioritet do të jete grumbullimi i vecuar dhe mos përzierja e mbetjeve të rrezikshme me mbetjet e ngurta urbane;
- Promovimin dhe stimulimin e të gjitha veprimtarite prodhuese që rezultojnë me me pak mbetje;
- Realizimin e një cikli sa më të shkurtër për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;
- Reduktimin sa më shumë të jete e mundur të lëvizjes dhe transportit të mbetjeve dhe asgjësimit të tyre të kryhet në impiantin më të afërt;
- Mbulimin e territorit me shërbimin e grumbullimit dhe transportin e sigurt të mbetjeve drejt impianteve të trajtimit,

Mbetjet duhet të trajtohen sipas hierarkisë së mbetjeve duke ju nënshtuar sa më shumë teknikave të reduktimit, riciklimit, kompostimit dhe përpunimit;

Të dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizikë dhe juridikë ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbetjeve;

Të garantohen kërkesat higjieniko- shëndetësore dhe të mënjanohet çdo rrezik për ndotjen e mjediseve urbane;

## NENI 7

### FAZAT E MENAXHIMIT TË MNU

Procesi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane përfshin krijimin, grumbullimin, ruajtjen dhe sistemimin e tyre nga prodhuesi i mbetjeve, dorëzimin sistematik në pikat e perkohshme të grumbullimit (PGM), largimin nga PGM për në lëndëfill, reduktimin ripërdorimin, ndarjen, riciklimin, përpunimin dhe trajtimin përfundimtar.

## NENI 8

### MBETJET OBJEKT I RREGULLORES

Objekt i kësaj rregulloreje janë MNU ( Mbetjet e Ngurta Urbane);

Në funksion të kësaj rregulloreje, Mbeturinat Urbane i ndajmë në dy kategori:

- Mbetje te ngurta urbane ku bejne pjese mbetjet shtëpiake, të cilat jane kryesisht te riciklueshme dhe të dekompozueshme të parrezikshme, të cilat përfshijnë mbeturina që mund të ri-përdoren ose mund të përpunohen duke u vënë në përdorim si lëndë e parë. Në këtë kategori përfshihen:
  - Mbetjet metalike ;
  - Mbetjet e lulishteve, kopeshëve;
  - **Mbetjet plastike;**
  - **Letrat dhe kartoni;**
  - Shishet e qelqit (qelqurinat).
- Mbeturina Urbane të Pariciklueshme dhe te parrezikshme, të cilat përmbledhin psh mbeturina ushqimore ( organike ) dhe kuzhine me perberje te fermentueshme , etj , te cilat permbledhin te gjitha mbeturinat urbane qe nuk perfshihen ne kategorine e Mbeturineve Urbane te Riciklueshme.

## NENI 9

### MBETJE TË TJERA JO OBJEKT I RREGULLORES

Mbeturinat që prodhohen nga ekonomitë familjare dhe subjektet e tjera, por që nuk përfshihen në Mbeturinat Urbane, si për shembull: mbeturinat e rrezikshme, mbeturina industriale dhe teknologjike, mbeturinat nga ndërtimi apo prishja e ndërtesave, mbeturina të vëllimshme etj, janë përgjegjësi e krijuesit ose zotëruesi fillestar i mbetjeve e kryen trajtimin e tyre vetë ose përmes një tregtari a përsone tjetër që kryen operacione trajtimi mbetjeve , në përputhje me *Nenin 21, pika 1 të Ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"* dhe Ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e Mjedisit"<sup>5</sup>.

Bashkia mund te ofroje pika alternative per grumbullimin e tyre, në bashkëpunim me Ministrinë e Linjës dhe institucionet përkatëse, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore përkatëse.

## KREU II

### VEÇIMI, SISTEMIMI DHE DORËZIMI I MBETURINAVE

## NENI 10

### VEÇIMI DHE SISTEMIMI I MNU

1.Familjet si dhe subjektet publike a private që gjatë veprimtarisë së tyre krijojnë mbeturina, i veçojnë ato në grupe si:

mbeturina ushqimore ( organike );

amballazhe<sup>5</sup> (plastike, qelq,leter , karton);

<sup>5</sup> VKM nr 177/2012 "Per ambalazhet dhe mbetjet e tyre"

<sup>5</sup> Ligji nr 10463/2011 I ndryshuar " Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" neni 21



metalike te permasave te vogla;

2. Secili grup duhet te grumbullohet me vehte, ne qese a kosha te vecante. Materialet e riciklueshme duhet te grumbullohen ne kontnier te vecante, per tu terhequr nga firmat e riciklimit (vecanerisht per materialet e plastikës dhe te kartonit).

#### NENI 11

##### MËNYRA E VENDOSJES TË KONTENIERËVE

Të gjithë subjektet që në përputhje me natyrën e veprimtarisë së tyre krijojnë lloje të ndryshme mbeturinash, janë të detyruar të kenë më shumë se një kosh për grumbullimin e ndarë e të veçuar të tyre. Koshat janë me ngjyra të ndryshme ose me mbishkrime të dukshme që orientojnë hedhjen e veçuar të mbetjeve urbane. Koshat vendosen në vende të dukshme dhe lehtësisht të përdorshme.

Mbeturinat urbane që prodhohen nga institucione/subjekte të tilla si, spitalet, ambulancat, qendrat shëndetësore, laboratorët, farmacitë, klinikat stomatologjike, shtetërore a private, detyrohen të përdorin kontenier të vecante e të diferencuar, vetëm për mbetjet urbane, të cilat do mblidhen me sistemin e konteniereve personal për mbeturinat urbane.

#### NENI 12

##### DORËZIMI I MNU

Sistemimi dhe dorëzimi i MNU nga familjaret dhe nga të gjithë subjektet e tjerë, bëhet vetëm në vendet publike të mbledhjes së mbeturinave që ka caktuar Bashkia me qese të mbyllura, ose me konteniere individuale që percaktohen sipas llojit të prodhuesit ≤ 1100 litra, sasisë së mbetjeve dhe infrastruktures;

Dorëzimi i tyre jashtë këtij rregulli, është shkelje dhe ndëshkohet si e tillë;

Tregëtarët dhe persona të tjerë që ushtrojnë shërbime ambulante, duhet të jenë të pajisur me kosh të posaçëm për grumbullimin e mbeturinave që u krijohen gjatë tregëtimit e shërbimit që u ofrojnë qytetarëve.

#### NENI 13

##### MJEDISËT PUBLIKE

Gjithë subjektet që kanë dyqane, pika shërbimi, godina si hoteleri, etj, si dhe tregëtarët ambulant, detyrohen të mbajnë pastër ambientin përreth, në një rreze prej 5 m, përfshi edhe trotuarin para ambientit të shërbimit. Ndalohet hedhja dhe depozitimi i mbeturinave të këtyre subjekteve në rrugë, në trotuare, në lulishte apo në mjedise (hapësira) të tjera publike.

#### NENI 14

##### KUFIZIMET PËR DORËZIMIN E MBETURINAVE URBANE

Dorëzimi i mbeturinave urbane është një detyrim i prodhuesit të mbetjeve, dhe si e tillë duhet të kryhet sipas menyrave, ditëve dhe orareve të percaktuara nga Bashkia si edhe mbështetur në kategorizimin e mbeturinave dhe prodhuesëve të percaktuar në këto rregullore.

Dorëzimi i mbeturinave teknologjike, ndertimore, mbeturinave të zanatit, mbeturina të vajrave lubrifikante si edhe mbeturina të tjera që nuk konsiderohen si mbeturina urbane

nga ligji nr.8094, date 21.03.1996 "Per largimin publik te mbeturinave" dhe nga kjo rregullore , do te behet ne zbatim të Legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore përkatëse. Dorëzimi i tyre në vendet e mbledhjes së mbeturinave të caktuara në qytet për mbeturinat urbane, është e ndaluar dhe ndëshkohet.

Mbeturinat ndërtimore dorëzohen në vendet e caktuara.Gjatë procesit të ndërtimit, riparimit apo prishjes, qytetarët, investitorët dhe subjektet ndërtues, marrin masa për largimin e vazhdueshëm të mbeturinave ndërtimore.

Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, në trotuare, në çdo mjedis publik, si dhe në pikat që ka caktuar Bashkia për mbeturinat urbane, është e ndaluar dhe përbën shkelje që ndëshkohet si e tillë.

Kalimtarët, mbeturinat e çastit si amballazhe të ndryshme, i dorëzojnë vetëm në koshat e vendosur në qytet ose që ndodhen para dyqaneve. Ndalohet hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike.

Mbeturinat që dalin nga krasitja e pemëve, e hardhive, nga punimet në oborre, në lulishte e parqe, para se të çohen në vendet e mbledhjes së këtyre mbeturinave, priten në pjesë të vogla e palosen për të mos bllokuar kazanët dhe vështirësuar transportin. <sup>6</sup>, dhe hidhen në ditën dhe orën e caktuar nga bashkia. Është e ndaluar të hidhen mbetje në PGM me mjete që zenë volume të gjelbërta më të mëdha se c'lejohen, sic janë tricikël, kamioncina, dum dume apo karrocë me kuaj.

#### NENI 15

#### PERDORIMI I KONTENIEREVE PUBLIKE

Kane te drejte te perdorin kontenieret publik:

- familjet brenda territorit të Bashkisë Shkodër,
- bizneset, te llojit tregetar , artizanal , sherbimesh , qe prodhojne mbeturina urbane , ku prodhimi ditor i cdo subjekti nuk i kalon sasine prej ¼ e volumit te nje kontenieri;
- Bisnesi i vogël, i mesëm dhe i madh, nuk lejohet të përdorë kontenierët publikë për mbeturinat që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturina të ngurta urbane".
- Te gjithë bizneset, institucionet private apo shtetore qe prodhojne mbeturina mbi kufizimin e Nenit 14, duhen te kene detyrimisht konteniere individuale brenda territorit te tyre .

Brenda Kantierit të ndërtimit cdo subjekt i pajisur me leje ndërtimi deklarim paraprak etj, është i detyruar të ketë një kontenier për mbetjet e ndërtimit .

### KREU III

## GRUMBULLIMI, LARGIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETURINAVE

<sup>6</sup> VKM 608/2014 " per percaktimin e masave te nevojshme per grumbullimin trajtimin e mbetjeve BIO si dhe kriteret dhe afatet per percaktimin e tyre"



## NENI 16

### GRUMBULLIMI I MBETURINAVE

Grumbullimi i mbeturinave behet ne pikat e grubullimit të mbeturinave (PGM ).

Pikat e grumbullimit te mbeturinave (P.G.M-te ) jane siperfaqe te vogla qe sherbejne per dorezimin e mbeturinave nga prodhuesit e tyre . P.G.M -të duhet të jenë të betonuara ose të asfaltuara dhe të pajisur me sinjalistikë horizontale aty ku mungojnë platformat përkatëse.

P.G.M-të ku vendosen e konteinerët, kazanët apo stacionet e betonuara për grumbullimin e mbeturinave, që miratohen nga Bashkia.

Bashkia miraton dhe publikon skemën konkrete të vend-ndodhjes së P.G.M-ve dhe strukturën e përmasat e secilës. Ndryshimi i vendndodhjes së P.G.M-ve, pa miratim të Bashkisë përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

Ofrimi dhe pranimi i sherbimit eshte i detyrueshem ne te gjithë territorin bashkiak, duke mos perjashtuar askend, vetem ne rastet kur Bashkia autorizon forma te perkohshme eksperimentale te grumbullimit te diferencuar te mbeturinave.

## NENI 17

### GRUMBULLIMI I MBETJEVE JO TË DIFERENCUARA

Sherbimi i grumbullimit te mbeturinave urbane ne menyre jo te diferencuar ofrohet nga Bashkia ne nje ose disa menyra specifike si :

- grumbullimi nepermjet konteniereve publike ne raste te vecanta dhe ne sheshe te ekologjike per kete qellim;
- grumbullimi nepermjet qeseve me metodën derë me derë;
- gumbullimi nepermjet konteniereve per hapësira private dhe te permasave te ndryshme;

Prodhuesi i mbeturinave mund te depozitoje mbeturina ne menyre individuale direkt e ne fushen e grumbullimit te mbeturinave urbane , ne perputhje me legjislacionin në fuqi;

Largimi publik i mbeturinave garanton grumbullimin e te gjithë mbeturinave urbane qe per cfaredolloj motivi gjenden jashte konteniereve , ne pikat ku sherbimi kryhet dere me dere si edhe grumbullimin e mbeturinave urbane qe gjenden te shperndara ne hapësirat publike .

## NENI 18

### GRUMBULLIMI ME KONTENIERE

Grumbullimi nepermjet konteniereve kryhet ne hapësirat publike bashkiake te banimit , bizneseve ose ne oborre te shoqerive private a publike dhe ne pergjithesi ne te gjitha vendet ku eshte parashikuar nje prodhim i konsiderueshem mbeturinash urbane.

Zbrasja e konteniereve kryhet sipas nje grafiku te percaktuar ne baze te nje kalendari operativ qe i komunikohen pareprakisht prodhuesit te mbeturinave urbane nen kujdesin e operatorit te sherbimit ose Bashkisë;

Menjëherë mbas largimit të mbeturinave territori pastrohet zona përreth PGM'së përreth sheshit të konteinerëve. Kjo sipërfaqe dezinfektohet me gëlqere të kloruar (deri 5% klor aktiv ose lëndë dezinfektuese) pas zbrasjes se mbeturinave urbane. Per kontenieret publike minimalisht nje here ne jave për qytetin në sezon veror, ndërsa për sezonin e

vjeshtë-dimër një herë në dy javë deri një herë në muaj për sezonin e dimrit. Standardi i shërbimit të grumbullimit do të konsiderohet i pranueshëm nga ana e grupit monitorues në qoftë se pas kryerjes së shërbimit në një rreze prej 5 m nga të gjitha anët e PGM nuk do të jetë presente asnjë papastërti.

Per asnje rast nuk do të lejohen konteniere të tejmbushur me mbeturina urbane, të patransportuara dhe mbeturina urbane të lëna në zonën përreth kontenierëve ose në vende të percaktuara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktore të jashtëm, operatori i shërbimit/Bashkia duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre.

Prodhuesi i mbetjeve është i detyruar të përdorë kontenierin e disponueshëm më të afërt dhe është i detyruar të mbyllë kapakun nëse kontenieri ka një të tillë; në rastet kur kontenieri është i tejmbushur nga qeset mbeturinat duhet të dorëzohen në kontenierin tjetër disponibel dhe nuk duhet të lihen asnjëherë në tokë;

Konsumatorët jo-banorë që prodhojnë më shumë se ¼ e sasisë që mund të hidhet në një kontenier mbetjesh (zakonisht 1.1m<sup>3</sup>) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të grumbullimit të mbetjeve.

#### NENI 19

##### GRUMBULLIMI DERË MË DERË

Bashkia sipas një vendimarrje mund të ofrojë shërbim alternativ të grumbullimit me derë më derë të mbeturinave të ngurta urbane në zona të caktuara urbane ose rurale.

Përdoruesi familjar/bizneset kanë detyrimin të nxjerrin jashtë objekteve ku banojnë dhe punojnë, pranë derës ose në një vend të percaktuar në hapësirën publike, qeset vetëm me mbeturina të ngurta urbane, gjithmonë në mënyrë të dukshme, të mbyllura në mënyrë të rregullt, për të mos krijuar pengesa apo rreziqe për kalimtarët, në orare të percaktuara dhe të miratuar nga Bashkia.

Mund të aplikohen pika grumbullimi të levizshme që janë mjete vete shkarkuese të hapura të tonazhit të vogël gjithmonë në orare dhe frekuenca të percaktuara.

Frekuenca dhe ora e grumbullimit përcaktohet nga operatori i shërbimit me miratimin e Bashkisë, si dhe lajmërimi i orarit bëhet nga Bashkia.

Qeset duhet të jenë në peshe jo më të mëdha se 20 Kg dhe nuk duhen të kenë objekte që presin, me majë, apo mbeturina të rrezikshme për personin përgjegjës për shërbimin manual të grumbullimit;

#### NENI 20

##### VENDOSJA DHE KARAKTERISTIKAT E KONTENIEREVE

Kontenieret parashikohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë grumbullimin në kohë dhe në sasi, midis flukseve të çdo cikli dorëzimi.

Caktimi i PGM-ve, duhet bërë duke respektuar kriteret e higjenes, në harmoni me infrastrukturën urbane, për më tepër me qëllim lehtësimin e largimit publik të mbeturinave. Për të gjitha ndertimet e reja, projektet e rikonstruksioneve apo zonave të reja urbane caktimi dhe miratimi i vendeve të grumbullimit të mbeturinave është i detyruar dhe bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

Kontenierët kanë sipërfaqe të lëmuara dhe janë lehtësisht të pastrueshëm. Kontenierët mbahen gjithmonë në kushte optimale pune nga subjekti që është angazhuar me administrimin e mbeturinave apo nga operatorët e shërbimit.

Kontenieret mund të jënë të llojeve si më poshtë vijojnë :

- konteniere të brendshme , me kapacitet vëllimetrik nga 120 litra deri në 360 litra;
- konteniere publike urbane me kapacitet vëllimetrik nga 700 litra deri në 3200 litra, për qëndrim jashtë;
- konteniere për mbetje të vëllimshme, të palëvizshme, pa rrota, me kapacitet vëllimetrik mbi 5500 litra ose 7700 litra , për qëndrime fikse dhe procesi i zbrastjes kryhet në mënyrë mekanike;
- konteniere me kompaktim, të palëvizshme, pa rrota, me kapacitet volumetrik të madh, me vetë-kompaktim (të pajisur me sistem hidraulik apo mekanik të pavarur).

#### NENI 21

##### **RUAJTJA HIGJENO - SANITARE PËR PUNONJESIT E SHERBIMIT**

Për ruajtjen higjeno sanitare të punonjesve të shërbimit të administrimit të mbeturinave , zbatohen normat në dispozicion për sigurinë dhe higjienën e punës . Punonjesit duhet të jënë të pajisur me veshje të përshtatshme dhe me mekanizma apo pajisje për mbrojtje personale , dhe duhet të nënshtrohet trajtimeve për kontrollë sanitare të parashikuara në ligj.

#### NENI 22

##### **TRANSPORTI I MBETJEVE URBANE**

Transporti publik i mbeturinave urbane për në vendet e depozitimit bëhet nga Bashkia ose nga një palë e ngarkuar prej saj ( operatori i shërbimit ) i caktuar nga Bashkia. Operatorë të tjerë urbane që mund të kryejnë aktivitete pastrimi apo grumbullimi, transporti apo depozitimi mbeturinash , në mënyrë të pavarur nga shërbimi publik, duhet të jënë të pajisur me licencë dhe lejet përkatëse.

Transporti organizohet e funksionon kryesisht në orët e mëbrëmjes ose herët në mëngjes, përveç rasteve të vecanta miratuar nga Bashkia në funksion të sezonit turistik, fluksit, avarive të mjeteve, etj., këto vetëm me autorizim të Bashkisë. Në rastin e zonave rurale, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të MNU mund të kryhet edhe gjatë orëve të ditës.

Transportimi i mbeturinave nga pikat e grumbullimit për në vendet e depozitimit e të përpunimit të tyre, bëhet me mjete teknologjike të posaçëm dhe të mbuluara, ngarkesa e të cilëve nuk rrezikon derdhjen apo rishpërndarjen e mbeturinave.

Kamionët që transportojnë lëndë dhe materiale ndërtimi ose që çojnë mbeturinat ndërtimore në vendet e depozitimit të tyre, marrin masa që gjatë lëvizjes të mos ketë derdhje apo rishpërndarje të mbeturinave që transportojnë.

Kamionët, autoveturat, etj, kur hynë në rrugët e qytetit nga kantierët e ndërtimit dhe nga rrugë dytësore të paasfaltuara, janë të detyruar të pastrojnë gomat nga balta, llaçet, betonet e çdo papastërti tjetër që ndot qytetin.

#### NENI 23

##### **PESHIMI I MBETJEVE URBANE**

Të gjitha mbetjet e grumbulluara, përpara ose gjatë depozitimit në proceset e recuperimit apo përpunimit final, peshohen nëpërmjet përdorimit të një sistemi peshimi rregullisht të

kolauduar. Në vazhdim të operacionit të peshimit duhet të kryhen edhe rregjistrimet e të dhënave.

Te gjitha te dhenat do te mblidhen dhe te ruhen ne kujdesin e operatoreve te ndryshem te sherbimeve dhe mund te survevizohen apo kerkohen nga Bashkia me ritme periodike qe percaktohen me pare.

## KREU IV

### ROLI I BASHKISË NË MENAXHIMIN E MNU

#### NENI 24

#### ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I SHËRBIMIT NË BASHKI

Bashkia Shkodër ka përgjegjësi direkte në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta sipas ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 23 dhe 33, në mënyrë të veçantë në "grumbullimin, transportimin, asgjësimin dhe trajtimin e mbetjeve ngurta urbane" përcaktuar si një funksion i bashkive.

Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtë dhe përgjegjësi për:

- Organizimin për ofrimin i shërbimit të grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane;
- Ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit të mbetjeve;
- Vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhja e të ardhurave;

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të menaxhimit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjive (plane, plan-veprime) dhe është i përfshirë në procesin e dhënies së lejes për një vend për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të rrezikshme (ligjit nr. 9537, date 18.05.2006 “ Per administrimin e mbetjeve të rrezikshme”).

Policia e Bashkiake është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve, për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me manaxhimin e mbetjeve. Policia Bashkiake është struktura konstatuese edhe zbatuese e kësaj rregullore në raste të evidentimit të kundravajtjeve administrative përcaktuar në këtë rregullore.

Kompanitë private/ose ndërmarrjet publike ofrojnë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e bashkisë, bazuar në kushtet e përcaktuara në kontratat e nëshkruar me bashkinë ose sipas detyrave funksionale të ndërmarrjeve publike.

Drejtoria e shërbimeve publike/Lagjet dhe njësitë administrative të Bashkisë Shkodër; zbatojnë me korrektësi procedurën standarte të veprimit “ Mbi administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit në Bashkinë Shkodër”, dokumenti bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Inspektorët përkatës monitorojnë ofrimin e shërbimit dhe raportojnë me anë të dokumentacionit përkatës në Bashkinë Shkodër në zbatim të PSV’së. Monitoruesit e njësisë të monitorimit të shërbimeve publike zbatojnë procedurën standarte të veprimit (PSV) duke informuar përgjegjësën e njësisë dhe plotësuar dokumentacionin përkatës. Ndërkohë ata janë të përfshirë në cdo kohë të monitorojnë pastrimin e qytetit dhe te

verifikojnë procesin e monitorim – raportimit nga ana e monitoruesve të njësive dhe lagjeve të bashkisë Shkodër sipas zonave përkatëse .

Bashkia në lëndfillin e Bushatit ka caktuar një supervisor, i cili kryen raportime të rregullta mujore në lidhje me ngarkesat e mbetjeve që vijnë në lëndfill nga i gjithë territori i bashkisë. ( bashkëlidhur PSV për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për Bashkinë Shkodër)

## KREU V

### PASTRIMI DHE MIREMBAJTJA E RRUGËVE

#### NENI 25

##### SHËRBIMI I PASTRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE

Qëllimi i këtij shërbimit është pastrimi (fshirja dhe mirëmbajtja) dhe larja e rrugëve me cilësi në Bashkinë Shkodër. Ky shërbim do të realizohet nga kompania/të ose ndërmarrje publike. Në kontratën përkatëse ose në detyrat funksionale të ndërmarrjes publike specifikohen të gjitha kriteret për pastrimin, kontrollin për zbatimin e tyre, si dhe sanksionet për mos zbatim të kriterëve të përcaktuar nga Bashkia.

Shërbimi ndahet në: (i) fshirje manuale të rrugëve gjatë turnit të natës, (ii) fshirje mekanike e rrugëve gjatë turnit të ditës/natës dhe (iii) shërbimi për grumbullim mbeturinash gjatë ditës (mirëmbajtës ditor).

Këtij shërbimi i nënshtrohen rrugët e asfaltuara, rrugët me kalldrëm, sheshet si dhe trotuarët kryesor të qytetit dhe të qendrës së banuar sipas listës të miratuar nga Bashkia Shkodër (përvec hapësirave që kërkohet pastrimi nga ana e bizneseve në një largësi 2-5 m).

Përdorimi i uniformave për punëtorët dhe i trajtimit special në përputhje me normat higjeno-sanitare është rigorozisht i detyrueshëm.

#### NENI 26

##### FSHIRJA DHE LARJA MEKANIKE E RRUGËVE

Rrugët dhe sheshet kryesore fshihen mekanikisht një deri dy herë në javë. Shërbimi realizohet gjatë turnit të natës nga ora 22.00 – 06:00

Fshirja mekanike realizohet nga një makinë fshesë, e cila përdoret për akset e lagjeve kryesore të qytetit. Gjithashtu është e nevojshme të realizohet fshirja mekanike e trotuareve dhe pedonale të qytetit duke përdorur një mjet më të vogël, ku makina fshesë nuk mund të hyjë.

Fshirja dhe larja e sipërfaqeve, të cilat nuk mund të aksesohen për shkak të parkimeve të mjeteve, do të rregullohet nga bashkëpunimi i sipërmarrësit me inspektoriatin rrugor mbi bazën e një grafiku të dakortësuar. Numri i larjeve përcaktohet sipas sezonit dhe kushteve konkrete. Bashkia përcakton rrugët dhe sheshet që duhet të lahen gjatë muajve Maj–Shtator sipas një grafiku të miratuar nga Drejtoria e Shërbimeve.

Për larjen e rrugëve përdoren automjete të posacme. Për larjen përdoret uji me ngarkesë bakteriale jo më shumë se 200 Ekoli për 100ml ujë. Në këto raste mund të përdoret edhe uji i puseve, lumenjve apo basenve të tjerë ujore.

## NENI 27

### FSHIRJA MANUALE E RRUGËVE

Fshirja manuale konsiston në largimin e hedhurinave, gjetheve, baltës dhe pluhurit nga rrugët trotuaret dhe sheshet e qytetit.

Mbetjet urbane që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve hidhen në pikat më të afërta të grumbullimit të mbetjeve urbane sipas llojit të mbetjeve që prodhohen.

Ndalohet kategorikisht dorëzimi i mbetjeve urbane që dalin nga pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve në pusetat e ujësjellësit, e ujërave të zeza, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferikë, në shtretërit e ujrave rrjedhëse, në basenet ujore natyrale apo artificiale.

Frekuenca e fshirjes manuale realizohet gjatë javës, gjatë turnit të natës, sipas grafikut të miratuar nga Bashkia. Gjatë turnit të ditës do të bëhet mirëmbajtja e rrugëve.

Punonjësit duhet të jenë të pajisur me veshje sigurie, si doreza, maska, kapele, roba pune me shenja dalluese të kompanisë dhe shenja dalluese të sigurisë.

Me qëllim për të garantuar mbajtjen pastër të hapësirave publike mund të vendosen dhe të administrohen nën kujdesin e operatorit të shërbimit/ose ndërmarrjes publike, koshat rrugore për mbetje urbane të dimensioneve të reduktuara të prodhuara për kalimtarët.

Kalimtarët, mbetjet e çastit si ambalazhe të ndryshme i dorëzojnë vetëm në koshat e vendosur në qytet ose që ndodhen para dyqaneve. Hedhja e tyre në rrugë, në trotuare apo në ambiente të tjera publike, përbën shkelje dhe ndëshkohet si e tillë.

## KREU VI

### DIFERENCIMI I MBETJEVE DHE QENDRA E MULTIGRUMBULLIMIT

## NENI 28

### DORËZIMI DHE GRUMBULLIMI I MBETJEVE URBANE NË MËNYRË TË DIFERENCUAR

Dorëzimi dhe grumbullimi i mbetjeve urbane në mënyrë të diferencuar realizohet nëpërmjet:

- Grumbullimi nëpërmjet konteneirëve, koshave të mbetjeve sipas tipologjive të vecanta;
- Grumbullimi nëpërmjet sistemit të grumbulluar derë më derë të mbetjeve sipas tipologjive të vecanta;
- Grumbullimi nëpërmjet qendrave të multigrumbullimit dhe/ ose shesheve ekologjike sipas tipologjive të vecanta. Sheshi ekologjik shërben për të kryer grumbullimin e fraksioneve të ndryshme të materialeve në një sipërfaqe ku janë sistemuar kontenerë të ndryshëm sipas llojit të mbetjes. Ky shesh ekologjik mund të marrë karakteristikat e një qendre multigrumbullimi kur bëhet fjalë për një sipërfaqe të rrethuar, e të lejueshme për përdoruesit vetëm në orare të caktuara, dhe ku për të cilën është caktuar një përgjegjës.



## NENI 29

### GRUMBULLIMI I DIFERENCUAR

Largimi publik i mbetjeve organizohet ne menyre te tillë qe të arrijë sa me teper te jete e mundur objektivin e reduktimit te prodhimit te mbetjeve urbane dhe te ndarjes ne burim per llojet e ndyshme te pjeseve qe i perbejne ato, duke tentuar reduktimin, me kalimin e kohes, te sasise se mbetjes se padiferencuar jo te riciklueshem dhe jo te rekuperueshem.

Grumbullimi i diferencuar do të realizohet me ngritjen e infrastrukturës të nevojshme, në zbatim të Legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore përkatëse, me një vendimarrje të caktuar në bashkëpunim me Ministrinë e linjës, donatorët etj.

Me realizimin e investimit të një qendre multigrumbullimi, nëpërmjet një amendamenti të kësaj rregulloreje vendosen kriteret e duhura të funksionimit dhe të menaxhimit të infrastrukturës grumbulluese dhe qendrës të multigrumbullimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e prodhuesve të këtyre mbetjeve, sipas tipologjive të veçanta .

## KREU VII

### ROLI I BIZNESEVE DHE KOMUNITETIT NË MENAXHIMIN E MNU

## NENI 30

### PASTRIMI I TERRITOREVE

Te gjitha hapësirat dhe territoret private pastrohen nga vetë pronarët e tyre.

Te gjithë personat fizikë dhe juridikë që kryejnë veprimtari stacionare ose ambulatorë, detyrohen të mbajnë pastër territorin përreth lokalit apo vendit të punës në nje rrezeveprimi deri në 5m.

Hapësirat private te cdo lloj aktiviteti duhet te pastrohen çdo ditë pas përfundimit të aktiviteve nga përdoruesit e tyre. Me pastrim të këtyre hapësirave, nënkupton së bashku me pastrimin e mbetjeve dhe pa pastërtive edhe pastrimin e borës dhe akullit.

Nëse personat juridik apo fizik që janë përdorues të territoreve private nuk kryen aktivitetet e pastrimit apo bëhet shkak për ndotje të territorit, bashkia ka të drejtë të njoftojë dhe më pas të sanksionojë kundravajtësin.

Te gjitha hapësirat e tjera publike që nuk janë të përfshira në skemën e pastrimit të qytetit pastrohen nga përdoruesit e këtyre hapësirave (banorët ose institucionet).

Ndalohet hedhja dhe derdhja e mbeturinave dhe ujrave që dalin nga pastrimi ose larja e lokaleve të shërbimit në trotuare, rrugë e sheshe të qendrave të banuara.

## NENI 31

### SHERBIMI I PASTRIMIT NE TREGJE

Administratoret e tregjeve, persona te vecante apo grup personash tregtare qe zene vendet e shitjes ne tregjet private apo publike, te organizuar ne hapësirat e publike ose private , duhet te administrojne vete pastrimin e territorit te tregut menjehere mbas mbylljes te

aktivitetit ditor. Per sa i perket administrimit te mbeturinave qe dalin nga keto tregje duhet te operohet si me poshte vijon:

Administratori i tregut privat apo perfaqesuesi i tregtareve eshte pergjegjes per mbledhjen dhe largimin e mbeturinave per ne fushen e depozitimit duke lidhur detyrimisht kontrata te vecanta me Bashkine ose operatore private sherbimi te licensuar , qe garantojne zbatimin e kushteve higjieno sanitare te kesaj rregulloreje.

Ne rastet e tregjeve publike qe administrohen nga Bashkia, ky sherbim perfshihet ne sherbimet e tjera te pastrimit qe administrohen nga Bashkia .

Detyrimisht cdo treg duhet te kete te miratuar nga Bashkia PGM-te e perkoheshme , brenda territorit te tregut , per te mundesuar vendosjen e konteniereve.

Të gjithë shitësit e tregut të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mbeturinat urbane që krijojnë gjatë tregëtimit të produkteve vetjake, i grumbullojnë te palosura apo te sistemuara ose te mbyllura ne qese , dhe i hedhin ne pikat e peraktuara nga Bashkia. Largimi nga tregu pa bere kete sistemim te mbeturinave konsiderohet shkelje dhe ndeshkohet si e tille ( deri ne moslejimin për të tregëtuar përsëri në treg).

#### NENI 32

### MANIFESTIMET PUBLIKE, PANAIRET, SPEKTAKLET LËVIZËSE DHE VEPRIMTARI TË STINËS

Veprimtaritë e stinës, Entet Publike ose Fetare, Fondacionet apo Shoqatat, Cirqet, Partite Politike, apo cfarolloj grupi qytetaresh, qe kane per qellim organizimin e nismave si: festa, panai, festime popullore, vrapime, spektakle levizese ose manifestime edhe te llojit kulturor apo sportiv, etj, ne rruge, sheshe dhe hapësira publike apo per perdorim publik, jane te detyruar te sigurojne direkt ose nepermjet marreveshjeve te vecanta me ndermarjet shteterore ose/dhe operatorin e sherbimit, mbajtjen paster te hapësirave, qe i jane dhene atyre per perdorim, si gjate aktivitetit ashtu edhe në përfundim të tij, duke dorëzuar ne kontenioret e pershtatshern te vendosur per kete qellim nga administratori, si mbetjet e prodhuara direkt nga aktiviteti i tyre ashtu edhe ato te prodhuara nga frekuentimi i manifestimeve prej qytetareve.

Detyrimet suplementare te dala nga kryerja e sherbimit publik, do ti ngarkohen organizuesve te manifestimeve.

## KREU VIII

### INFORMIMI I PUBLIKUT PER MENAXHIMIN E MNU

#### NENI 33

#### DETYRIMI PER INFORMIM

Bashkia harton planin lokal të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane përmes një procesi me pjesëmarrjen e të gjitha grupeve të interesit përfshirë edhe publikun.

Bashkia zgjedh opsionin më të mirë praktik, me kosto më të ulët, më të pranueshëm nga pikëpamja sociale dhe në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane pas konsultimit me grupet e interesit përfshirë edhe publikun.



Në procesin e vendim-marrjes për përcaktimin e tarifave për çdo opsion të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane ftohen të marrin pjesë të gjitha grupet e interesit përfshirë edhe publiku i interesuar.

Në procesin e vendimmarrjes për përcaktimin e vendeve të impinteve të trajtimit dhe për shfrytëzimin e tyre, ftohen të marrin pjesë të gjitha grupet e interesit përfshirë edhe OJF-të mjedisore dhe publiku i interesuar.

Kushdo ka të drejtë të kërkojë të informohet për ecurinë e procesit të largimit publik të mbeturinave, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara për këtë çështje.

Personat fizik e juridik që janë angazhuar në largimin publik të mbetjeve, që kanë dhe përdorin impiante të trajtimit të mbetjeve, duhet të publikojnë të dhënat që u rezultojnë nga monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarive të tyre jo më rrallë se një herë në tre muaj.

#### NENI 34

##### FUSHATAT E INFORMIMIT DHE TE SENSIBILIZIMIT

Bashkia bën publike skemën e pastrimit, oraret e pastrimit dhe oraret e preferueshme për dorëzimin dhe largimin publik të mbeturinave.

Bashkia dhe kompania kontraktuese kujdeset për fushatat e nevojshme të informimit, edukimit dhe sensibilizimit për të stimuluar bashkpunimin me biznesin dhe komunitetin.

Duhet të promovohen nga drejtoritë përkatëse në bashki sipas rastit në bashkëpunim me personat juridik të përfshirë në fushata edukimi dhe informimi drejtuar qytetarëve me synim specifikimin mbi:

- Ndarjen e mbetjeve sipas fraksioneve të riciklueshme dhe të kompostueshme për të cilat është aktivizuar shërbimi i grumbullimit të diferencuar;
- Qëllimin dhe mënyrat e kryerjes së shërbimeve;
- Destinacionet e fraksioneve që rikuperohen;
- Detyrimet dhe detyrat për dorëzimin në mënyrën e duhur të mbetjeve;

Në mënyrë të veçantë fushatat e informimit dhe sensibilizimit mund të realizohen;

- Përgatitja e materialeve informuese, si kalendari periodik i fushatave ndërgjegjësuese, broshura, postera apo stenda për në ambjentet e bashkisë, shkollave apo zonave të ndryshme të qytetit ku pilotohen nismat për grumbullimin e diferencuar/riciklimin/kompostimin;
- Përgatitja e spoteve publicitare informuese për fushatat intensive periodike gjatë vitit kalendarik;
- Hedhja e informacioneve informuese në faqen e internetit të bashkisë dhe shpërndarja e informacionit në rrjete sociale;
- Përfshirja e ekspertëve/trajnuesve të jashtëm që do të kryejnë sesionet e trajnimit në shkolla dhe në komunitet;
- Përgatitja dhe printimi i materialeve trajnuese për shkollat dhe komunitetin;

#### NENI 35

##### OPINIONI I QYTETAREVE

Bashkia duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacionit për të marrë ankesat. Numri i ankesave të marra dhe të zgjidhura brenda një muaji është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

Bashkia duhet të masë kënaqësinë e publikut për cilësinë e shërbimit të pastrimit përmes sondazheve me pyetësorë, të paktën 1 herë në dy vjet.

#### NENI 36

#### BASHKEPUNIMI ME ORGANIZATA JO FITIMPRURËSE

Në aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane, Bashkia mund të bashkëpunojë me shoqatat vullnetare, OJF-te, apo grupime të tjera të interesit me pjesëmarrës nga publiku etj.

Organizatat jo fitimprurëse kryejnë kontribute të nevojshme, me qëllim sensibilizimin e komunitetit, ndihmën në grumbullimin në mënyrë të duhur të mbetjeve ose pastrimin e qytetit, të frymëzuar nga qëllime mjedisore, pa qëllime përfitimi duke përdorur aktivitetet vullnetarizmi apo projekte;

Organizatat jo fitimprurëse mund të përfshihen edhe në grumbullimin e pjesëve specifike të mbetjeve urbane të rikiklueshme, pas nënshkrimit të marrëveshjeve me Bashkinë, me paraqitjen e kërkesave të nevojshme që tregojnë mënyrat e kryerjes së grumbullimit, llojet e materialeve që grumbullohen dhe destinacioni i tyre, për më tepër edhe mjetet që do të përdoren për kryerjen e shërbimit me qëllim garantimin e higjenes dhe sigurisë së punës që do të kryhet.

Aktiviteti i organizatave jo qeveritare autorizohen nga Bashkia, e cila përcakton vendin dhe mënyrat dhe rregullat e ndëryhrjes etj.

### KREU IX

#### ORARET E HEDHJES SE MBETJEVE PER FAMILJARET, ENTET PUBLIKE DHE BIZNESET

#### NENI 37

#### ORARET E HEDHJES SE MBETJEVE URBANE

Oraret e hedhjes se mbetjeve urbane do te jene:

- Per familjaret dhe entet publike do të zbatohen dy fasha orare, në mëngjes orari 06:00-09:00 dhe në darkë orari 20:00-22:00;
- Per subjektet private,bizneset,tregjet,orari i hedhjes se mbetjeve do te jete vetëm në këto dy fasha orare,14:00 deri ne oren 17:00 dhe 20:00 deri ne oren 00:00.

Bazuar ne piken 1 te nenit 10 te kesaj rregullore: për bizneset si supermarketet, restorantet, hotelet, familjet, subjektet private dhe publike, qe krijojne mbetje gjate veprimtarise se tyre, te natyres si:

- a. Mbeturina ushqimore (organike, nga restorantet etj)
- b. Amballazhe (plastike, qelq, leter, karton, vecanerisht nga marketet supennarketet etj)
- c. Metalike te permasave te vogla;

Dorezimi ditor i mbetjeve urbane ne nje volum me te madh se e volumit te nje kontenieri publik eshte i ndaluar me ligj, per rrjedhoje te gjitha bizneset apo instirucionet private/shteterore qe prodhojne mbetje mbi kufizimin e lejuar, duhet te kene detyrimisht hapësire individuale brenda territorit te tyre ku kryhet aktiviteti, dhe duhet te mbledhin

ne forme te vecante me qese ose kosha ngjyra te ndryshme ose me mbishkrime te dukshme qe orientojne hedhjen e vecuar te mbetjeve urbane te sipercituara.

## KREU X

### KONTROLLI DHE SANKSIONET

#### NENI 38

##### NDALIME DHE DETYRIME

Shkeljet ndaj rregullores përbëjnë kundravajtje administrative dhe ndëshkohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

~~Përveç ndalimeve të shprehura qartë në nenet e rregullores është e ndaluar hedhja, derdhja dhe depozitimi në hapësirat publike, në tregjet publike të hapura apo të mbuluara, e çdo lloj mbetje e ngurtë, gjysëm e ngurtë, e lengët e çdo lloji natyre dhe dimensionit edhe pse e mbyllur me qese. Ky ndalim është në fuqi edhe për sipërfaqet ujore, lumenjtë, kanalet, burimet e ujit, gropat, brigjet anët e rrugëve etj.~~

Gjithashtu është e ndaluar dorëzimi i mbetjeve urbane në vendet e zbuluara të hapësirave private. Pronarët e tyre janë të detyruar të kujdesen për mbajtjen pastër të tyre dhe të mos lejojnë kthimin e tyre në vende të depozitimit të mbeturinave.

Cilido që shkel ndalimet e përmendura më sipër është i detyruar të kryejë largimin e mbetjeve. Ky veprim duhet të kryhet nga pronari apo personi me të drejta të deleguara mbi hapësirën e ndotur. Kryetari i Bashkisë cakton operacionet e nevojshme dhe afatet brenda të cilave duhet të veprohet si dhe periudhën kohore për shlyerjen e dëmit monetar.

Është e ndaluar dorëzimi i mbetjeve inerte/të vëlleshme në pikat e grumbullimit të mbetjeve urbane, veprim që mund t'i shkaktojë dëmtime kontenierit ose mjeteve të grumbullimit apo personave përgjegjës për shërbimin.

Është e ndaluar për qytetarët dhe për këdo person të paautorizuar të kryejë çdo lloj selektimi manual të mbetjeve të dorëzuara brenda kontenierëve, kërkimi apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenierë ose pranë impianteve të rikuperimit dhe përpunimit final.

Është e ndaluar dorëzimi i mbetjeve nga aktivitete prodhimi, përpunimi, trajtimi, etj si dhe mbetje të papranueshme të përcaktuara në këtë rregullore, në kontenierët publik apo në pikat e grumbullimit të mbetjeve.

Është e detyrueshme për të gjithë prodhuesit dhe mbajtësit e mbetjeve urbane nëse këto të fundit janë objekt i grumbullimit të ndarë me qëllim rikuperimin e materialeve dhe energjisë, të dorëzojnë këto mbetje në përputhje me mënyrat e caktuara në shërbimet respective.

Është e ndaluar spostimi i kontenierëve apo pikave të grumbullimit, pajisjeve të përdorura për shërbimin e grumbullimit, dëmtimi apo përmbysja e tyre

Janë ndaluar sjelljet që shkaktojnë pengesa apo vonesa në kryerjen e shërbimit, duke përfshirë edhe parkimin e mjeteve pranë kontenierëve apo në hapësirat e manovrimit të mjeteve për shërbimin e grumbullimit të mbetjeve apo shërbimit të fshirjes.

Është e ndaluar hedhja e mbetjeve të vogla në hapësira publike apo për përdorim publik (lëkura frutash, letra apo copa letrash, cigare kuti, shishe dhe të ngjashme).

Është e ndaluar dorëzimi (hedhja) në kontenierë apo në mjetet e përdorura për grumbullimin e mbetjeve, i mbetjeve të lëngëta, me qese të zgjidhura apo jo të lidhura mirë, e substancave të ngrohta, ndezëse, të rrezikshme, e mbetjeve spitalore, apo kafshëve

të ngordhura për më tepër mbetje të forta (inerte) që mund të dëmtojnë kontenierin ose përbëjnë rrezik për komunitetin.

Djegia e mbetjeve urbane në kontenierë, rreth tyre dhe në çdo ambient tjetër, është kategorikisht e ndaluar dhe ndëshkohet si shkelje e rëndë sepse gazrat e tymërat e djegies rrezikojnë shëndetin e njeriut.

Ndalohet prezenca dhe kullotja e kafshëve shtëpiake dhe barngrënëse në mbetjet urbane të kontenierëve e në pikat e grumbullimit të tyre, si dhe marrja prej mbetjeve të ushqimeve për kafshët si mbetje buke, etj.

Ndalohet mbi volumin e caktuar në ligj  $\frac{1}{4}$  e kontenierit, hedhja në kontenieret publik apo në pikat e grumbullimit, mbetjet e gjelbra të prodhuara nga krasitjet e pemeve, barit apo punimet në kopshte dhe oborre, apo e mbetjeve të tjera me origjinë bujqesore sezonale.

~~Nuk pranohet e drejta për të kërkuar përjashtimin nga shërbimi i zakonshëm i ofruar për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbeturinave pa miratimin e Bashkisë.~~

#### NENI 39

#### KONTROLLI

Përveç kompetencave të organizmave përgjegjëse me ligj për kontroll, Bashkia aktivizon mbikëqyrjen për të respektuar rregulloren duke aplikuar sanksione administrative të parashikuara në të.

Autoritetet e caktuara për kontroll janë të autorizuar të kryejnë të gjitha inspektimet që mendojnë të nevojshme, për të vërtetuar respektimin e normave të caktuara në rregullore.

Bashkia ka të drejtën të kërkojë nga prodhuesit e mbetjeve speciale të paraqesin dokumentacionin vërtetues të prodhimit apo përpunimit që kryhet.

Në rastet e vërtetimit për mosrespektim të rregullores, Bashkia nëpërmjet një akti të motivuar nga arsye sanitare, higjienike dhe mjedisore, vendos kryerjen e punimeve të nevojshme, barrë kjo në ngarkim të subjektit përgjegjës për ndotje. Gjithashtu urdhëron adaptimin e masave oportune për të parandaluar përsëritje të mosrespektimit të rregullores, si dhe marrjen e masave penalizuese sipas normave në fuqi.

Në rastet e lënies së mbetjeve në hapësirat publike ose për përdorim publik, ku nuk është identifikuar subjekti përgjegjës për ndotje, Bashkia kryen me shpenzimet vetiake grumbullimin e mbetjeve dhe përpunimin e mëtejshëm.

#### NENI 40

#### SANKSIONET PËR SHKELJEN E RREGULLORES

Shkeljet të dispozitave të kësaj Rregulloreje, përbëjnë kundravajtje administrative dhe dënohen sipas modaliteteve dhe mënyrave të parashikuara si më poshtë vijon:

Sanksionet për kundravajtjet administrative, të parashikuara më sipër, ekzekutohen brenda 5 ditëve. Ankimimi për to bëhet në përputhje me ligjin Nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative".

Kundravajtësi përveç se do të riparojë dëmin dhe do të pastrojë ambientin duke e kthyer në gjëndjen e mëparshme, për shkelje administrative do të penalizohet si më poshtë cituar për çdo kategori :

## Aneksi "A"

*Për kundravajtje ndaj kësaj rregulloreje, aplikohen sanksionet administrative si më poshtë :*

Shkelja	Sanksioni Administrativ
a. Dorëzimi (hedhja) e mbetjeve urbane jashtë konteniereve dhe jashtë pikave të Grumbullimit (PGM);	
b. Djegia e mbetjeve urbane në konteneirë, në PGM'të në territore publike dhe private brënda territorit të Bashkisë Shkodër;	Për qytetarë/individë : 5.000 lekë 15.000 lekë (në mënyrë të
c. Dorëzimi (hedhja) ditore e mbetjeve urbane në kontenerë, në një volum më të madh se 1/4 e volumit të një konteneri publik;	përsëritur)
d. Ndotja me dhe e baltë e rrugëve dhe trotuarëve gjatë transportit ose punimeve në kantierët e ndërtimit;	Persona fizikë/juridike:20.000lekë 20.000lekë(në mënyrë të përsëritur)
e. Dorëzimi(hedhja) e mbetjeve të castit, ambalazhet, mbetjet e ngurta, organike etj në hapsiat publike, trotuarë, rrugë, lulishte plazhe etj;	
f. Dorëzimi(hedhja) e mbetjeve të ngurta urbane në koshat e vegjël që janë të destinuar vetëm për mbetje të castit nga kalimtarë turistë apo vizitorë ;	
g. Dorëzimi(hedhja) mbetjeve të ngurta, apo mbetjeve nga shërbimi i pastrimit, në pusetat e elektrikut, ujësjellësit, basenet ujore, etj;	
h. Mos kryerja e pastrimit të territorit apo vendit të punës mbas mbarimit të aktivitetit , për tregjet apo tregëtarët ambulantë para lokaleve apo vendit të punës në gjerësi 2-5 m.	
i. Hedhja ,derdhja në trotuare e ujrave dhe mbetjeve të ndryshme nga pastrimi apo larja e lokaleve të shërbimit, dyqaneve etj;	
j. Dorëzimi(hedhja) e mbetjeve në kontenerë/PGM në ditë dhe orare të ndryshme nga ato të përcaktuara nga Bashkia;	
k. Dorëzimi i pasistemuar, i papalosur, apo i pambyllur i mbetjeve tregtare, si dhe mosdorëzimi i tyre në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga Bashkia;	
l. Shkarkimi, depozitimi i mbetjeve nga makinat e madhësive të ndryshme në territore publike brenda territorit të Bashkisë;	
m. Dorëzimi ( hedhja) e mbetjeve të vëllimshme,mbetjeve të ndërtimit apo konteniereve apo në vendet e grumbullimit të mbetjeve urbane;	
n. Kryerja e selektimit manual , kërkimit apo marrje të mbetjeve të dorëzuara në kontenerë , etj nga persona të pa autorizuar;	

o. Dorëzimi (hedhja) në kontenerë apo në mjetet e përdorura për grumbullimin e mbetjeve , i mbetjeve të lëngëta, me qese të zgjidhura apo jo të lidhura mirë, e substancave të ngrohta, ndezëse, të rrezikshme, e mbetjeve spitalore, apo kafshëve të ngordhura për më tepër mbetje të forta (inerte) që mund të dëmtojnë kontenerin ose përbëjnë rrezik për komunitetin;

Për qytetarë/individë : 5.000 lekë  
15.000 lekë (në mënyrë të përsëritur)

p. Dorëzimi (hedhja) e mbetjeve nga aktivitete prodhimi , përpunimi, trajtimit, industrial etj, si dhe mbetje të papranueshme të përcaktuara në rregullore, në kontenerët publik apo në PGM;

Persona fizikë/juridike: 20.000 lekë  
20.000 lekë (në mënyrë të përsëritur)

~~q. Ndryshimi abuziv i PGM-eve apo kontenierëve, sipas vendodhjeve të përcaktuara nga Bashkia;~~

r. Parkimi i mjeteve para ose pranë pikave të grumbullimit të mbetjeve ose në hapësirat e manovrimit të mjeteve të pastrimit;

s. Hedhja e mbetjeve të krasitjeve të pemeve, mbetjet nga punimet në kopshtari, korrja e barit etj mbi volumnin e përcaktuar nga Bashkia (mbi ¼ e volumnit të kontenerit publik), ose jashtë ditëve dhe orareve të përcaktuara nga Bashkia;

t. Dëmtimi ose djegia e pjeshme e kontenierit .